



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Nr. __prot.

Belsh më: 10.04.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-SHERBIM

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “ Hartim Plani për mbarshtrimin e pyjeve ne territorin e Bashkise Belsh”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): Hartimi i planeve 71243000-3

Vlera e fondit limit: **1 654 260** (nje million e gjashtëqind e pesedhete e kater mije e dyqind e gjashtedhete)leke pa TVSH

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike ,kriteret e veçanta të kualifikimit është kryer nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit nr,28 datë 28.01.2026 ,referuar nenit 76 të pikës (a), nenit 11 te VKM nr.285,datë 19.05.2021 te Keshillit të ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, që përcakton “ cmimet e botuara nga instituti i statistikave (INSTAT) ,ose /dhe te tjera zyrtare ,të njohura nga institucionet perkatese ,(si,pershëmbull ,nga organet tatimore dhe doganore, dhomat e tregtisë , në manuale etj.

Ne bazë t ë nenit 21 ,pika2 ,neni 35 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ,neni 2, ,pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, tëVKM nr.285,datë 19.05.2021 te Keshillit të ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar ,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Belsh ka hartuar proceverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurë e sipërcituar, me përmbajtje si më poshtë :

Hartimi i dokumentave të tenderit u bë në përputhje me **ligjin Nr,162/2020 date 23.12.2020 “ Për Prokurim Publik” si dhe VKM nr 285 date 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa

vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional te operatoreve ekonomik:

Sipas përcaktimeve të bëra ne shtojcës 9) te DST-ve (Kriteret e Pergjithshme te perzgjedhjes /Kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se, citojmë : ”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomik bazuar në :a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtari profesionale;...2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët të regjistrohen në një nga regjistrat profesional ose tregtar.”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të fondit limit që prokurohet. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Shënim: “Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar ne nenin 41 pika 2 ku përcaktohet se: “Kërkesa te veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 41 pika 2 ku përcaktohet se: “Kërkesateveçantatëkualifikimitduhettëpërfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhjen e nenin 77, të LPP-së.

Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë q ë plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qenë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës. Referuar sa më sipër duke qenë se vlera e fondit limit objektin është nën kufirin e ulët monetar që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 55 pika 4 e VKM Nr.285, dt.19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

- 2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të maturuara të parashikuara nga Pushteti Vendor **për vitin 2025** sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar);prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. dhe **vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin e fundit(këstet e maturuara), duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” I ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore(këstet e maturuara për vitin 2026).**

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë,” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2, nenin 77 pika 3 e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” I ndryshuar.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Njësia e prokurimit përcaktoi kritere që janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë **jo më të vogël se 20%** të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55 pika 4/b), të VKM NR.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar .Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbime e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit , që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në

nënin e sipërcituar. *Përcaktimi I vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore së sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.*

Përvoja e mëparëshme është një element i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomik mbi bazë të vlerave të kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitet për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Ne nenin 55 “PROCEDURË E HAPUR E THJESHUAR” pika 4/b të vendimit të këshillit të ministrave me NR.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë :4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Lidhur me kërkesat për përvojat e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara do të jetë: b) Për kontratat e mallërave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është e realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalles së njoftimit të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal I kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për tu vendosur në DST. Fjala “kërkon” nënkupton se këto kriteret janë detyruese, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e Prokurimit me objektin e mësipërme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të kompanisë/shoqërisë, i cili të jetei pajisur me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve e kullotave leshuar nga institucioni i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit sipas VKM nr. 284 dt.29.04.2022 “*Per përcaktimin e rregullave dhe procedurave, kritereve për pajisje me certifikate eksperti në fushën e pyjeve dhe kullotave*”, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.
- c) Certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve e kullotave

Shënim: *Në procedurat e prokurimit me një fazë,” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në VKM-ne Nr.538, date 26.05.2009 “Per licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullave të tjera nenligjore të perbashketa” e ndryshuar, për licencat e grupit të trete, VKM nr. 284 dt.29.04.2022 “Per përcaktimin e rregullave dhe procedurave, kritereve për pajisje me certifikate eksperti në fushën e pyjeve dhe kullotave, në ”Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019, pasi kerkohen ekspert të fushës për realizimin me sukses të studimit.*

2.3.3 Një punësim mesatari të paktën **6 (gjashte)** punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per periudhen e fundit te deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit te deklaruar, shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpapa publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit te mesiperme per numerin minimal te punonjesve duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet/sherbimet.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj eshte kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf kryesor për kryerjen e të gjitha shërbimeve në objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- 2 (një) Inxhinier Pyjesh
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpapa publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar ne mbeshtetje të pikës 4 të nenit 77 të Lgjit

nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 4 gërma b, c e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ku përcaktohet shprehimisht se : 4. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c)fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe , në ”Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019, duke mare ne konsiderate se objekti ka nje siperfaqe te konsiderueshme te pyjeve e kullotave ,si dhe kohezgjatja e kontrates qe eshte per nje afat kohor 6 muaj . Objekti i kontratës për hartimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave përfshin një volum të konsiderueshëm pune në terren dhe në zyrë, duke përfshirë inventarizimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore, grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave dendrometrike dhe gjeohapësinore, hartimin e hartave tematike, si dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe strategjik në përputhje me kërkesat e “Manualit të planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”. Gjithashtu, realizimi i këtij objekti brenda afatit kohor të përcaktuar kërkon një organizim të mirë të punës dhe angazhim paralel të proceseve në terren dhe në zyrë.

Në këtë kuadër:**Inxhinieri i Pyjeve** është i domosdoshëm për realizimin e komponentit teknik dhe silvikulturor të projektit, konkretisht për: vlerësimin e gjendjes së fondit pyjor dhe kullosor; analizën e treguesve dendrometrikë, biologjikë dhe ekologjikë; përcaktimin e masave të mbarështimit, trajtimit dhe rigjenerimit; hartimin e planit të menaxhimit dhe programit të ndërhyrjeve në përputhje me legjislacionin dhe manualin përkatës. **Inxhinieri Gjeodet** është i domosdoshëm për realizimin e komponentit gjeohapësinor dhe hartografik të projektit, konkretisht për kryerjen e matjeve në terren dhe përcaktimin e koordinatave të sakta gjeografike; përpunimin e të dhënave topografike dhe gjeohapësinore; hartimin e hartave tematike (ndarje parcelare, harta pyjore dhe kullosore, etj.); ndërtimin dhe menaxhimin e bazës së të dhënave GIS, e cila është pjesë integrale e planit të mbarështimit.

Duke marrë në konsideratë sipërfaqen e konsiderueshme të fondit pyjor/kullosor që do të inventarizohet, natyrën ndërdisiplinore të shërbimit, si dhe afatin kohor për realizimin e kontratës, prania e të dy këtyre specialistëve është thelbësore për të garantuar zhvillimin paralel dhe të koordinuar të proceseve në terren dhe në zyrë, si dhe për të siguruar saktësinë teknike dhe cilësinë e produktit final.

Në këtë kuadër, kërkesa për Inxhinier Pyjesh dhe Inxhinier Gjeodet është në përpjesëtim të plotë me natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e kontratës dhe nuk përbën kufizim të konkurrencës, por një garanci të nevojshme për realizimin me sukses të saj.

3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/UNI/ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI/ISO 14001 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “d” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

Objekti i kontratës lidhet me hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, një proces kompleks që përfshin punime në terren, grumbullim dhe përpunim të të dhënave, analiza teknike dhe hartim dokumentacioni strategjik për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Për këtë arsye, kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë si cilësinë e shërbimit, ashtu edhe respektimin e standardeve mjedisore.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

Ndërsa certifikimi **ISO 14001** garanton se operatori ekonomik:identifikon dhe menaxhon ndikimet mjedisore të aktivitetit të tij; zbaton politika për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të

burimeve natyrore; respekton legjislacionin mjedisor në fuqi; siguron që aktivitetet në terren dhe proceset e punës të kryhen me përgjegjësi mjedisore.

Në këtë kuadër, kërkesa për këto certifikime është në përpjesëtim me natyrën dhe rëndësinë e kontratës dhe shërben si garanci që operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të realizuar me cilësi të lartë dhe në përputhje me standardet mjedisore objektin e prokurimit.

2.3.5 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Automjete per transport	1 copë	Ne pronesi ose me qera
Station Total	1 copë	Ne pronesi ose me qera
Aparat GPS	2 copë	Ne pronesi ose me qera
Diamert mates	2 copë	Ne pronesi ose me qera
Turjel trusler	2 copë	Ne pronesi ose me qera
Lazer meter	1 copë	Ne pronesi ose me qera
Pjerresi mates +lartesi mates(hypsometer)	1 copë	Ne pronesi ose me qera
Busulla	1 copë	Ne pronesi ose me qera
Meter shirit10-20ml	2 copë	Ne pronesi ose me qera

a)Për pajisjet e mesiperme , të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqese fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë dhe fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore.

c)Për (automjetin) mjetet në pronësi duhet të paraqitet: -dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit(akti i pronësisë); - leje qarkullimi; -çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); - siguracion mjeti (i vlefshëm); Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: - kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi - leje qarkullimi; - çertifikaten e kontrollit teknik e vlefshme -siguracion mjeti (i vlefshëm);

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë,” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4 dhe në nenin 41, pika 4, gërma ç) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili përcakton se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale,

autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në rastin konkret, objekti i prokurimit lidhet drejtpërdrejt me **hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave**, i cili është një shërbim me komponent të theksuar terreni dhe teknik, që përfshin procese si: inventarizimi pyjor dhe matjet dendrometrike; përcaktimi i koordinatave dhe hartëzimi; analizat e strukturës dhe zhvillimit të masivit pyjor; përpunimi i të dhënave në funksion të hartimit të planeve të menaxhimit. Për realizimin e këtyre proceseve, pajisjet e kërkuara nuk janë elemente formale, por **mjete minimale të domosdoshme teknike**, pa të cilat realizimi i kontratës nuk mund të kryhet në mënyrë të saktë dhe profesionale.

Në mënyrë më konkrete:

- **Pajisjet topografike (GPS, Total Station)** janë të nevojshme për përcaktimin e koordinatave dhe hartëzimin e saktë të sipërfaqeve pyjore;
- **Instrumentet dendrometrike (diametërmatës, hipsometër, lazer meter)** mundësojnë matjen e parametrave kryesorë të drurit (diametri, lartësia, volumi), të cilët janë bazë për hartimin e planeve të mbarështimit;
- **Turjela incrementale (Trusler)** përdoret për analizën e moshës dhe rritjes së drurëve, element kyç për vlerësimin e gjendjes së pyllit;
- **Pajisjet orientuese dhe matëse (busull, metër shirit)** janë të nevojshme për punën në terrene të vështira dhe për verifikime në terren;
- **Automjeti i transportit** është i domosdoshëm për aksesin në zona pyjore, të cilat karakterizohen nga terren i thyer dhe mungesë infrastrukture.

II. Argumentimi specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga : Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit, kriterëve të vecanta” mbështetur ne VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, në varësi të objektit të kontratës përcjell sipas termave te references me nr 879 date 26.03.2026 nga Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike krijuar me urdhërin nr,28 datë 28.01.2026 *Specifikimet teknike të hartuara për mallra objekt prokurimi, përshkruajnë elementet me të rëndesishëm përbërës , që garantojnë cilësinë e kërkuar në përputhje me parashikimet e nenit 4 , pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar si dhe nenit 40 pika 2 e VKM nr.285, date 19.05.2021”Per miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar cdo kërkesë funksionale ose performance, dhe cdo standard të kërkuar, referuar kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare.*

NJËSIA E PROKURIMIT PUBLIK: